

**VENDIM**  
**Nr. 292, datë 17.5.2023**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË**  
**TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”, shtohen dy individë, të renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË**  
**TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT  
 (“LISTA E OKB-së”)

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME**  
**ORGANIZATAT ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-QAIDA***

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”:

1. MAULAWI; RAJAB
2. SULTAN AZIZ; AZAM

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.